



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 17.03.2025
Numër Protokolli: 2226/2025

A.nr.17/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.17/2025, të datës 06.01.2025, të parashtruar nga ankuesja SH.B, kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.17/2025 e datës 06.01.2025, ashtu që aprovohet pretendimi lidhur me shkelje procedurale në procedurën e pranimit me numër të referencës RN00013758, ndërsa, refuzohen pretendimet tjera sikurse në ankesë.
- II. Ndryshohet** Njoftimi me numër protokolli 3686, i datës 14.12.2024, lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues si dhe Njoftimi i datës 30.10.2024, lidhur me fazën e verifikimit paraprak, në procedurën e së pranimit me numër të referencës RN00013758, pozita e punës Inspektor i Arsimit, SIA Ferizaj, ashtu që, kandidati M.K, largohet nga lista e konditave fitues dhe lista e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e verifikimit paraprak, ndërsa, pjesët tjera të njoftimit me numër protokolli 3686, të datës 14.12.2024 si dhe njoftimit të datës 30.10.2024, mbesin të pandryshuara.
- III. Mbetet në fuqi** Njoftimi me numër protokolli 3687 i datës 14.12.2024, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare në procedurën e pranimit me numër të referencës RN00013757, pozita e punës Inspektor i Arsimit, SIA Prishtinë.
- IV. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjithë veprimet e nevojshme administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, ashtu siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.
- V. Obligohet** Divizioni i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në procesin e verifikimit përfundimtar para emërimit sipas nenit 14 të Rregullores (QRK)

Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në mënyrë që emërimi i kandidatëve të behët vetëm pas sigurimit të dëshmisë përkatëse që provon faktin së kandidatët e suksesshëm të mos kenë ushtruar funksione politike në 3 (tre) vitet e fundit.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, SH.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 06.01.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, e pranuar me datë 06.01.2025, dhe e regjistruar nën shenjen A.nr. 17/2025, lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve fitues në procedurat e pranimi me numër të referencës RN00013757 dhe RN00013758, për pozitën e punës Inspektori i Arsimit, të shpallura nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (*në tekstin e mëtejme referuar: MASHTI*), ndërsa, kjo e fundit, më datë 28.01.2025, ka përcjellë dokumentet lidhur me çështjen në procedurë, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 38/2025 të datës 06.01.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Testin individual me shkrim për procedurën me referencë RN00013758; Testin individual me shkrim për procedurën me referencë RN00013757; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.01.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 22.01.2025, së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit-MASHT; Konkursin me numër reference RN00013757 të datës 05.04.2024, SIA-Prishtinë; Listën e aplikantëve (*aprovuar dhe refuzuar*); Njoftimin e datës 30.10.2024; Vendimin Ref:10/Nr.prot.774 të datës 04.11.2024; Vendimin Ref: 10/Nr.prot.785 të datës 05.11.2024; Akt emërimit Nr.29/2024 të datës 05.09.2024; Akt emërimit e datës 15.10.2024; Akt emërimit e datës 02.04.2012; Akt emërimit Nr.52/2024 të datës 05.09.2024; Akt emërimit e datës 02.04.2012; Njoftimin për testin me shkrim të datës 14.11.2024 për dy procedurat e rekrutimit; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit të pranimi të datës 05.12.2024; Esenë si dhe çelësin e esesë për procedurën me referencë RN00013759; Esenë si dhe çelësin e esesë për procedurën me referencë RN00013757; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimi të datës 26.11.2024; Njoftimi i datës 14.12.2024 për shpalljen e kandidatëve fitues për procedurën me referencë RN00013757-SIA Prishtinë; Aplikacionin e ankueses me datë aplikimi 05.05.2024 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni i kandidatit M.I me datë aplikimi 03.05.2024 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni i kandidatit B.V me datë

aplikimi 03.05.2024 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Konkursin me numër të referencës RN00013758 grupi i arsimit pozita Inspektor i Arsimit në SIA Ferizaj; Kopjen e ID-së së ankuesit; Njoftimi me numër protokollit 3686, i datës 14.12.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 29.01.2025; Vendimin Ref.10/Nr.Prott.774 të datës 04.11.2024 dhe Vendimin Ref.10/Nr.Prot.785 të datës 05.11.2024 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit për themelimin e Komisionit të Pranimi dhe Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimi; Listën e aplikantëve; Listën e verifikimit paraprak e datës 30.10.2024; Formularët e vlerësimit të eses të datës 26.11.2024; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për kandidatët fitues datës 04.12.2024; Aplikacionin e kandidatit D.Sh i datës 02.05.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-50; Aplikacionin e kandidatit A.T të datës 29.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-30; Aplikacionin e kandidatit A.L i datës 08.04.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-77; Aplikacionin e kandidatit B.R të datës 28.04.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-24; Aplikacionin e kandidatit S.Th të datës 22.04.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-18; Aplikacionin e kandidatit E.D të datës 04.05.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-33; Aplikacionin e kandidatit M.K me dokumentacionin nga faqe 1-30; Aplikacionin e kandidatit F.R të datës 30.04.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-3; Kërkesën për informata zyrtar e datës 20.02.2025 nga AB. Për A.R; E-mailin e datës 24.02.2025 nga A.R për A.B; Diplomën me Nr. 2081 të studimeve master të kandidatit M.K, Vendimin A.nr.1144/2024 të datës 11.09.2204, i KPMSHCK-së; Vendimin me numër protokollit 780/2025 të datës 03.02.2025 të Kryetarit të Këshillit; Vendimin A.nr.1127/2024, të datës 23.09.2204 të Këshillit, Njoftimin me numër protokollit 2165, të datës 24.07.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Njoftimin me numër protokollit 2163, të datës 24.07.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton së Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 05.04.2024, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00013757, Grupi i arsimit, pozita Inspektor i Arsimit-SIA në Prishtinë, klasa Profesional 1, katër vende pune, si dhe konkursin publik me numër reference RN00013758, Grupi i Arsimit, pozita Inspektor i Arsimit-SIA në Ferizaj, klasa Profesional 1, shtatë vende pune, të hapur për aplikim nga data 06.04.2024 deri më datën 05.05.2024.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja ka aplikuar në dy konkurset si më sipër, duke u përfshirë në listën e verifikimit paraprak si kandidate që ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale. Tutje, sipas shkresave të çështjes rezulton se procedura e pranimi më numër reference RN00013757, Inspektor i Arsimit-SIA në Prishtinë, kishte përfunduar me Njoftimin me numër protokollit 2163, të datës 24.07.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore, lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare, mirëpo, pas ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

nga M.H, si kandidat në këtë procedurë, Këshilli me Vendimin A.nr.1127/2024, të datës 23.09.2024, ka aprovuar ankesën e palës ankuese, ka anuluar Njoftimin me numër protokoll 2165 të datës 24.07.2024, dhe çdo veprim tjetër deri në fazën e verifikimit paraprak, ndërsa procedura e pranimi është në fazën e verifikimit paraprak.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të çështjes rezulton se procedura e pranimi me numër reference RN00013758, Grupi i Arsimit, pozita Inspektor i Arsimit-SIA në Ferizaj kishte përfunduar me Njoftimin me numër protokoll 2164, të datës 24.07.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, mirëpo, pas ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga kandidati me inicialet N.S, Këshilli me Vendimin A.nr.1144/2024 të datës 11.09.2024, ka aprovuar ankesën e palës ankuese, ka anuluar Njoftimin me numër protokoll 2164, të datës 24.07.2024, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare si dhe çdo veprim tjetër deri në fazën e verifikimit paraprak, duke obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të MASHTI-it që të rishillojë procedurën e pranimi për këtë pozitë nga faza e verifikimit paraprak.

Në zbatim të vendimit të Këshillit A.nr.1144/2024, më datë 14.10.2024, dhe Vendimit A.nr. A.nr.1127/2024, të datës 23.09.2024, Divizioni i Burimeve Njerëzore i MASHTI-it, ka njoftuar kandidatët në këto procedurë lidhur me rivefikim paraprak, kështu që, si rezultat kësaj, ankuesja serish është përfshirë në listën e verifikimit paraprak si kandidatë që ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale, dhe mbi këtë bazë e njëjta i është nënshtruar edhe fazës së vlerësimit të testit me shkrim në të dy procedurat e pranimi, me ç'rast në testin me shkrim për konkursin me numër reference RN00013757, pozita Inspektor i Arsimit-SIA Prishtinë, ka grumbulluar gjithsejtë 47.4 pikë, nga rrjedhë se ankuesja nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, ndërsa, në konkursin me numër reference RN00013758, pozita Inspektor i Arsimit-SIA Ferizaj, ka grumbulluar gjithsejtë 51 pikë, nga rrjedhë se njëjta ka arritur pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazat tjera të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë, ashtu që, e njëjta ka akumuluar 81 pikë, duke u renditur si kandidatja e 10 me numër rendor.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në MASHTI, më datë 14.12.2024, ka publikuar Njoftimin me numër protokoll 3683, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për pozitën Inspektor i Arsimit-SIA Ferizaj, ku si rrjedhojë si kandidatë fitues më shumë pikë kanë rezultuar D.SH më 90 pikë, A.T më 89.4 pikë, A.L më 87.4 pikë, B.R më 86.8 pikë, S.TH me 85.2 pikë, M.K më 84.6 pikë, E.D më 82.2 pikë.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit më datë 14.12.2024, ka publikuar njoftimin me numër protokoll Nr.3685 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për pozitën Inspektor i Arsimit-SIA Prishtinë, ku si kandidatë fitues janë shpallur: M.I me 82.6 pikë dhe B.V me 79.8 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se përzgjedhja e kandidatëve fitues në procedurën e pranimi me numër të referencës

RN00013757 SIA-Prishtinë dhe procedurën më numër reference RN00013758 SIA Ferizaj, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke mos respektuar rregullat dhe parimet që rregullojnë shërbimin civil. Shton se testi më shkrim është përcjell me shkelje të rëndësisë absolute për shkak se pyetjet me shkrim kanë qenë të pasakta dhe nuk kanë pas përgjigje të sakta. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën dhe të anuloj procedurat e kontestuar në tërësi.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i aktit të shpalljes së konkursit më numër të referencës: RN00013758, dhe konkursit me numër të referencës: RN00013757, ka gjetur se si kriteret të përgjithshme formale, lidhur me këtë pozitë janë përcaktuar: *Të kenë së paku titull master (300 ECTS), Të kenë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën e arsimit dhe të mos kenë ushtruar funksione politike në 3 (tri) vitet e fundit*, ndërsa, tek pika 5 e konkursit lidhur me dokumentet që duhet dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre është kërkuar: *Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës; Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështete se paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; Kopjen e certifikatave të trajnimeve; Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rënda në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucione publike”.*

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë lidhur më këtë çështje juridike-administrative, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 9 paragrafi 1: *“1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t’i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t’u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”*

-Nenit 39 ku përcaktohet: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së..... 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak*

përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit....”

Në kontekst të kriterëve specifike të përcaktuara për pozitën e shpallur, Inspektor i Arsimit, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: **2. Përgjithshëm, për pozita specifike të zyrtarëve publikë, mund të kërkojnë kriterë specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.**

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, me theks të veçantë:

Nenin 19 : *Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi.*

Nenin 20 : *1. Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkojnë për pozitën përkatëse.*

Nenin 21: *Procedura dhe forma e përshkrimit të punës 1. Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozitës së punës. 2. Përshkrimi i punës shërben për: 2.1. të njohur nëpunësin civil me punën që duhet të kryejë; 2.2. vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës; 2.3. vlerësimin e rezultateve në punë; 2.4. përcaktimin e kriterëve për çdo pozite pune në shërbimin civil. 3. Përshkrimet e vendeve të punës hartohen dhe ndryshohen kur krijohen institucionet e reja, kur ndryshon organizimi i brendshëm, zgjerohet mandati apo fushëveprimi apo shtohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit përkatës. 4. Përshkrimi i vendeve të punës hartohet nga Grupi i vlerësimit të klasifikimit, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të pozitës së punës. 5. Përshkrimi i vendeve të punës miratohet nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit, pas pëlqimit nga DMZP, për institucionet e administratës shtetërore. Ndërsa institucionet tjera, mund të kërkojnë mendim këshillimor në DMZP para miratimit nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit. 6. Përshkrimet e punës të miratuara si në paragrafin 7 të këtij neni, vendosen në SIMBNj nga NjMBNj e institucionit përkatës. 7. Përshkrimi i punës për pozitë të shërbimit civil bëhet*

sipas formës standarde të përcaktuar në Shtojcën Nr. 3, që është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje..

Referuar kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin e pa kontestuar se në varësi të natyrës, përgjegjësi dhe faktorëve të komplikimit të pozitës përkatëse të punës, mund të përcaktohen kritere specifike shtesë për këtë pozitë punës, çdo herë duke ndjekur kërkesat ligjore dhe procedurale të përcaktuara me ligj dhe akt nënligjor. Rrjedhimisht, në rastin konkret kërkesat e përgjithshme formale për pozitën e shpallur janë të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, e me të cilat dispozita parashihet se: *“2. Inspektorët e arsimit zgjedhën në pajtim me procedurat e Ligjit për Shërbimit Civil. Përveç kushteve të parapara me Ligjin për Shërbimin Civil, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe këto kritere: 2.1. të kenë së paku titull master (300 ECTS); 2.2. të kenë të paktën pesë (5) vjet përvojë pune në arsim. 2.3. të mos ketë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit”.*

Referuar kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses në ndërlidhje edhe me provat material të lëndës, dhe si rrjedhojë erdhi në përfundimin se nuk kanë mbështetje pretendimet ankimore referuar testit me shkrim, mbi arsytet se pyetjet e testit me shkrim kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatet, gjegjësisht, testi ka përmbajt 25 pyetje me përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja, pra struktura e testit ka qenë e përgatitur në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rrjedhimisht, duke u bazuar në shqyrtimin e testit të ankueses dhe çelësit të përgjigjeve, Kolegji nuk verën të meta në vlerësimin e drejtë të ankueses lidhur saktësinë dhe llogaritjen e përgjigjeve. Me konkret, në testin me shkrim për procedurën e rekrutimit RN00013758, pozita Inspektor i Arsimit SIA-Ferizaj ankuesja ka dhënë 22 përgjigje të sakta duke arritur 44 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar me dy pikë), ndërsa në ese është vlerësuar me 7 pikë, duke grumbulluar në total 51 pikë, Ndërsa, lidhur me procedurën e rekrutimit RN00013757, pozita Inspektor i Arsimit SIA-Prishtinë, ankuesja ka dhënë 21 përgjigje të sakta, duke arritur 42 pikë, në ese është vlerësuar me 5.4 pikë, duke akumuluar në total 47.4 pikë, numër ky i pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë...”* Rrjedhimisht, në kontekst të pretendimit ankimor se pyetjet dhe përgjigjet e testit me shkrim kanë qenë të pasakta, Kolegji konsideron së një pretendim i tillë është i përgjithësuar, duke mos specifikuar së cila apo cilat pyetje të testit kanë qenë me përgjigje të pasakta.

Ndërlidhur me respektimin e parimit të meritokracisë si parim bazë në shërbimin civil, dhe njëherë edhe si pretendim kryesor i palës ankuese, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e kandidatëve fitues për procedurën e pranimin me numër reference RN00013757, pozita Inspektor i Arsimit SIA-Prishtinë nga dhe ka gjetur këtë gjendje të fakteve:

-Kandidati M.I posedon: Diplomën Nr.817 të datës 18.02.2009, për përfundimin e studimeve themelore me datë 11.10.2006, në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marr titullin

bachelor i Etnologjisë, Diplomën Nr.273/15 të datës 31.03.2015, të lëshuar nga Kolegji “Victory” për përfundimin e studimeve master, duke marrë titullin Master i Arteve për Politikën Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim posedon Dëshminë me numër Nr.624/1 të datës 30.04.2024 dhe referencës së datës 29.04.2024, të udhëzuarit të Përgjithshëm në Agjencinë për Arsim, dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, më të cilat dëshmohet se kandidati punon në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, në pozitën Zyrtar për Çështje Profesionale dhe Pedagogjike, nga data 01.01.2016 e tutje, si dhe Vërtetimin Nr.prot.271 të datës 23.0.2022, të lëshuar nga Qendra e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” me të cilin vërtetohet se që nga data 27.01.2020, mbanë pozitën si mësimdhënësi i Qendrës së Karrierës.

- **Kandidati B.V** posedon: Diplomën Nr.959 të datës 10.10.2012, për përfundimin e studimeve themelore me datë 19.07.2012, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marrë titullin bachelor i Historisë-Edukatë Qytetare, Diplomën Nr.120 të datës 08.12.2016, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për përfundimin e studimeve master, Edukimi-Udhëheqja në Arsim. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim posedon Vërtetimin 134/2 të datës 23.11.2022, të lëshuar nga SHFMU “Rilindja” Podujevë, me të cilin dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënësi i ciklit klasor nga data 24.09.2014 deri më datën 31.07.2016 si dhe Vërtetimin Nr.13-426/2022 të datës 23.11.2022, të lëshuar nga Komuna e Podujevës, me të cilin dëshmohet se i njëjti është në marrëdhënie pune si Zyrtar për arsim të lartë në Drejtorinë për Arsim nga data 01.08.2016 e tutje.

Ndërsa, nga shqyrtimi i dosjeve të kandidatëve fitues për procedurën e pranimin me numër reference RN00013758, pozita Inspektor i Arsimit SIA-Ferizaj Kolegji ka gjetur këtë gjendje faktike:

-**Kandidati D.SH** posedon: Diplomën me Nr.91 të datës 15.08.2011, për përfundimin e studimeve themelore më datë 17.07.2009, në Fakultetin e Edukimit, Programi Fillor, Universiteti i Prishtinës; Diplomën (nr. i pa identifikueshëm) e datës 28.03.2019, për përfundimin e studimeve master më datë 05.03.2019, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Master i Edukimit, Mësimdhënie dhe Korrikulë. Lidhur me kriterin e përvojës së punës kandidati ka ofruar si dëshmi Vërtetimin Nr.268/2023 të datës 20.10.2023 të lëshuar nga Drejtori i Shkollës Filllore dhe e Mesme e Ulët “Abaz Ajeti”, në Gjilan dhe Vendimin më numër protokollit 74/2024 të datës 02.04.2024, më të cilat dokumente dëshmohet se kandidatja nga data 25.10.1999 deri më datë 31.08.2022, ka punuar si mësimdhënëse klasore pranë kësaj shkolle, ndërsa prej datës 12.09.2022 është drejtoreshë në shkollën e Mesme dhe të Ulët “Nazmi Hoxha”

-**Kandidati A.T** posedon: Diplomën me Nr.1089 të datës 25.02.2013, për përfundimin e studimeve themelore më datë 19.07.2012, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” duke marrë titullin Bachelor i Biologjisë-Kimisë; Diplomën nr. 6178, e datës 21.07.2022, për përfundimin e studimeve themelore më datë 05.07.2022, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marrë titullin bachelor i Teknologjisë-Informatikës, Diplomën me Nr.263 të datës 18.04.2018, për përfundimin e studimeve master më datë 06.07.2022, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, master i edukimit, mësimdhënie dhe korrikulë. Lidhur me

përvojën e punës në arsim i njëjti posedon Vërtetimin Nr.prot:355/2023, të datës 16.05.2023, të lëshuar nga Drejtori i Shkollës Filllore të Mesme e Ulët “Azemi e Salihu” në Dabishec, sipas të cilit vërtetohet së kandidati ka qenë mësimdhënës i Biologjisë në këtë shkollë nga data 14.04.2014 deri më datë 01.09.2022; Vërtetimin Nr. prot: 961/24 të datës 24.04.2024, të lëshuar nga të lëshuar nga Drejtori SHFMU “Ali Kelmendi” në Barilevë, më të cilin konfirmohet së i njëjti nga data 01.10.2022 vazhdon të punoj si mësimdhënës i lëndës së Biologjisë, pranë kësaj shkolle.

-Kandidati A.L posedon: Diplomën Nr.1812 të datës 31.05.2010, për përfundimin e studimeve themelore më datë 14.02.2005, në Fakultetin e Filologjisë, Dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe, Universiteti i Prishtinës, Diplomën Nr.133 të datës 21.06.2013, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me të cilën dëshmohet se më datës 19.12.2012, ka përfunduar studimet master në Fakultetin e Filologjisë duke marr titullin Master i Shkencave Filologjike dega Letërsi Shqipe. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti ka ofruar si dëshmi Vërtetimin më numër protokollit 02-418/2024 të datës 08.04.2024, të lëshuar nga Drejtori i SHFMU “ Razim Cakolli” në Shtërpçë, më të cilin vërtetohet së nga data 01.03.2002 deri me 31.08.2007, dhe nga data 01.09.2023 e tutje është i angazhuar si mësimdhënës i lëndës së Gjuhës shqipe dhe letërsisë, nga data 01.09.2007 deri me 31.08.2018 ka qenë Drejtor i SHFMU “ Razim Cakolli “, si dhe Vërtetimin nr.prot: 151/2024, të datës 08.04.2024, të lëshuar nga drejtori i Shkollës së Mesme të Lartë “Kongresi i Manastirit” në Firajë, më të cilin dëshmohet së kandidati ka qenë profesor i i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi nga data 01.09.2018 deri 31.08.2023 pranë Shkollës së Mesme të Lartë “Kongresi i Manastirit”.

-Kandidati B.R, posedon: Diplomën me Nr. 37 të datës 17.01.2018, për përfundimin e studimeve themelore më datë 05.07.2017, në Fakultetin e Edukimit në Gjilan, Universiteti Publik “Kadri Zeka”, duke marr titullin Baçelor i Arsimit Fillor, BA, Diplomën me Nr. 961 të datës 12.07.2021, për përfundimin e studimeve Master më datë 04.06.2021, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marr titullin Master i Edukimit Inkluziv. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti ka deponuar si dëshmi Vërtetimin Nr. protokollit 68/02 të datës 24.04.2024, të lëshuar nga Drejtori i SHFMU “Dëshmorët e Lubishtës”, Viti, më të cilin është vërtetuar së i njëjti nga data 01.12.2017 deri 31.05.2018, ka qenë i angazhuar si mësimdhënës klasor në SHFMU ” Mirali Sejdiu”, ndërsa, nga data 01.09.2018 vazhdon të punoj si mësimdhënës klasor në SHFMU “Dëshmorët e Lubishtës” Viti

-Kandidatja S.TH, posedon: Diplomën me Nr.279 të datës 01.12.2003, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, për përfundimin e studimeve themelore më datë 25.02.2003, në Fakultetin e Filologjisë, duke marr titullin Profesor në degën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe; Diplomën me Nr. 995/17 të datës 25.07.2017, të lëshuar nga Kolegji Universum-Prishtinë, e sipas të cilës dëshmohet së me datës 11.02.2017 ka mbaruar studimet Master i Arteve në Menaxhment. Lidhur me përvojën e punës në arsim e njëjta posedon Vërtetimin nr. prot:02/352 të datës 16.04.2024, të lëshuar nga Zyrtari Administrues i SHFMU “Ibrahim Krasniqi” në Lipjan, më të cilin është vërtetuar së kandidatja S. Thaqi, nga data 01.03.1996 deri më datë 31.08.2002 ka qenë e angazhuar si mësuese klase, nga 01.09.2002 deri më 30.09.2008 si Arsimitare, dhe prej datës 01.10.2008 vazhdon në pozitën e Drejtoreshës së Shkollës.

-Kandidati E.D, posedon: Diplomën me Nr.2233 të datës 08.09.2015, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” e sipas të cilës dëshmohet se më datë 10.07.2015, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Edukimit, duke marr titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze; Diplomën Nr.1385 të datës 14.02.2023, për përfundimin e studimeve master me datë 21.12.2022, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marr titullin Master i Edukimit-Mësimdhënie dhe Kurrikulë. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës në arsim i njëjti posedon Vërtetimin Nr.protokolli:212/2023 të datës 03.05.2024. të lëshuar nga Drejtori i SHFMU “Fehmi e Islam Kastrati” në Kishnarekë , me të cilën dëshmohet se i njëjti nga data 01.09.2016 vazhdon të punoj ende në si mësimdhënës i gjuhës angleze, pranë kësaj shkolle.

-Kandidati M.K, posedon: Diplomën Nr.1978 të datës 11.04.2012, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e sipas të cilës dëshmohet se më datë 28.02.2006, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik, Universitet i Prishtinës, duke marr titullin Profesor Historisë, si dhe posedon Certifikatën Ref.Nr.275/85 të datës 10.06.2013 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, përmes të cilës dëshmohet se më datë 16.05.2013, kreu të gjitha provimet e parapara në studimet master, në Departamentin e Historisë, dhe mori titullin master i Historisë, Drejtimi Koha e Re. Ndërlidhur me përvojën e punës, posedon Vërtetimin Nr. 708/2012 të datës 21.03.2012, të lëshuar nga Drejtori i SHFMU “Migjeni” Lipjan, më të cilin vërtetohet se nga data 02.02.2005 deri më datë 31.08.2005, ka qenë angazhuar si arsimtar i lëndës së Historisë pranë kësaj shkolle; Vërtetimin Nr. 1740/2 të datës 26.11.2019, të lëshuar Drejtori i SHMU “Dy Dëshmorët” Dobrajë e Madhe, më të cilin është konfirmuar se kandidati nga data 10.05.2006 deri më datë 31.08.2008 ka punuar në këtë shkollë pa përcaktuar angazhimin, Vërtetimin Nr. protokoli 55/2021 të datës 01.03.2021, të lëshuar nga Drejtori i SHFMU “Kadri Beba” Ribar i Madhë, sipas të cilit rezulton se nga 25.07.2008 deri më datë 01.03.2021, ka qenë Drejtor i kësaj shkolle, dhe shkresën e datës 26.04.2024, të lëshuar nga Drejtori i DKA-së të Komunës së Lipjanit, më të cilin është vërtetuar se i njëjti nga viti 2008 deri më datë 01.03.2025 ka kontratë valide si zëvendës Drejtor i SHFMU “V.Frashëri” në Lipjan.

Mbi bazën e konstatimeve si me sipër, rrjedhë se kandidatët fitues në për procedurën e pranimin me numër reference RN00013757, pozita Inspektor i Arsimit SIA-Prishtinë kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale, e duke qenë se të njëjtit kanë arritur numrin e pikëve të nevojshëm për tu konsideruar si kandidatë të suksesshëm, atëherë, me të drejtë Divizioni i Burimeve Njerëzore i organit të punësimit ka shpallur të njëjtit kandidatë të suksesshëm për procedurën përkatëse të rekrutimit, siç përcaktohet me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, kështu që pretendimet ankimore lidhur me këtë procedurë nuk kanë mbështetje ligjore.

Referuar gjendjes së fakteve si më sipër lidhur me procedurën e pranimin me numër reference RN00013758, pozita Inspektor i Arsimit SIA-Ferizaj, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se kandidatet D.SH, A.T A.L, B.R, S.TH dhe E.D, kanë përmbushur kriteret formale lidhur me pozitën përkatëse të punës, e duke qenë se të njëjtit sipas vlerësimeve të testin me shkrim dhe intervistën me gojë kanë arritur të grumbullojnë edhe pikët e nevojshme për tu konsideruar kandidat të suksesshëm, atëherë, më të drejtë Njësia e Burimeve Njerëzore të organit të punësimit të njëjtit i ka shpallur si kandidat të

suksesshëm në pajtim me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ndërsa, Njësia e Burimeve Njerëzore të organit të punësimit në fazën e verifikimit paraprak nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale duke e përfshirë kandidatin M.K si kandidat që ka plotësuar kriteret formale, sepse siç u sqarua si me sipër i njëjti si dëshmi lidhur me kriterin e arsimit master ka ofruar vetëm certifikatën Ref.Nr.275/85 të datës 10.06.2013, e që në vlerësimin e Kolegjit dhe ashtu siç është përcaktuar më klauzolën nr. 5 të Konkursit si dëshmi për të vërtetuar kriterin e arsimit në këtë rast studimeve master është përcaktuar diplomë. Rrjedhimisht, një konstatim të tillë Kolegji e mbështeti në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku lidhur me kriterin e përgjithshëm formal referuar kualifikimit arsimor si dëshmi është përcaktuar diploma. Andaj, në mungese të këtij dokumenti njësia përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me vet kriteret e përcaktuara me konkurs ku citojmë: 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:.... ***Kopjen e diplomës të kërkuar më konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës.....*** Andaj, mbi këto konstatime dhe rrethana, rrjedhë se është i bazuar pretendimi ankimor lidhur me përzgjedhjen e kandidateve në procedurën e pranimi me numër reference RN00013758, pozita Inspektor i Arsimit SIA-Ferizaj.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në dispozitat e nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht e konsideroj si pjesërisht të bazuar ankesën të ankueses, ashtu që ndryshoj Njoftimin me numër protokoli 3686, të datës 14.12.2024, lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues si dhe Njoftimin e datës 30.10.2024, lidhur me fazën e verifikimit paraprak, në procedurën e së pranimi me numër të referencës RN00013758, pozita e punës Inspektor i Arsimit, SIA Ferizaj, ashtu që, kandidati M.K, largohet nga lista e konditave fitues dhe lista e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e verifikimit paraprak, ndërsa, pjesët tjera të njoftimit me numër protokoli 3686, të datës 14.12.2024 si dhe njoftimit të datës 30.10.2024, mbasin të pandryshuara. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokoli 3687 i datës 14.12.2024, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare në procedurën e pranimi me numër të referencës RN00013757, pozita e punës Inspektor i Arsimit, SIA Prishtinë. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjithë veprimet e nevojshme administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, ashtu siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit. Ndërsa, obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që në procesin e verifikimit përfundimtar para emërimit sipas nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në mënyrë që emërimi i kandidateve të suksesshëm të behët vetëm pas sigurimit të dëshmisë përkatëse që provon faktin se kandidatët të mos kenë ushtruar funksione politike në 3 (tre) vitet e fundit.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje*

*Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.
Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.17/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses SH.B;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MSHTI-së dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.